



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Primijsen/Prodato Received/Delivery	07-06	2021	1	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKP/MSH/CK	2917/2021		1/4	



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.381/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, sipas Aktgjykimit A.nr.2077/2019 të datës 29.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.209/2019 të datës 20.03.2019 të parashtruar nga ankuesja me adresë Fshati "Leletiq/Magure, Komuna e Lipjanit, kundër Vendimit me numër Nr.1-101-68980 të datës 07.03.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Lipjanit, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 04.06.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet si e bazuar** ankesa me numër A.nr.209/2019 e datës 20.03.201, e parashtruar nga ankuesja
- II. **Shfuqizohet** Vendimi me numër 1-101-68980 i datës 07.03.2019, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Lipjanit dhe **Anullohet** Konkursi me numër 1-111-4492 i datës 22.01.2019 për vendin e punës "Zyrtar për Shërbime Sociale 2" në Komunën e Lipjanit si dhe të gjitha veprimet administrative që rrjedhin nga kjo procedurë e rekrutimit.
- III. **Obligohet** Kryetari i Komunës së Lipjanit për zbatimin e këtij vendimi në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

## A r s y e t i m

Komuna e Lipjanit në bazë të Autorizimit të datës 17.01.2019 të Departamentit të Administrimit të Shërimit Civil pranë Ministrisë së Administratës Publike, me datë 21.01.2019 ka shpallur konkursin publik për pozitën "Zyrtar për Shërbime Sociale 2", në Drejtoratin për Shëndetësi dhe Punë Sociale, e në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesja.

Komuna e Lipjanit përmes e-mailit të datës 21.02.2019, ka njoftuar ankuesen se e njëjta nuk është përfshirë në listën e shkurtër, me arsyetimin se nuk ka plotësuar kushtet e konkursit respektivisht atë të përvojës së punës pas diplomimit. Kundër këtij njoftimi, ankuesja parashtron ankesën me numër 1-111-13488 të datës 28.02.2019 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Lipjanit. Ky i fundit me Vendimin me numër 1-101-68980 të datës 07.03.2019, ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e ankueses.

Ankuesja e pakënaqur me Vendimin me numër 1-101-68980 të datës 07.03.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Lipjanit, brenda afatit ligjor medatë 20.03.2019 përmes adresës elektronike të KPMSHCK-së ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 1504/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 21.03.2019 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komuna e Lipjanit. Ndërsa me datë 29.03.2019, Këshilli ka pranuar nga Komuna e Lipjanit dokumentacionin lidhur me procedurën e kontestuar të rekrutimit si dhe provat shtesë sipas emalit të datës 02.05.2019.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në mungesë të kuorumit për vendosje ka udhëzuar ankuesin për ushtrimin e mjeteve juridike në gjykatë sipas dispozitave të Ligjit për Konfliktin Administrativ. Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, më datë 29.04.2021 ka nxjerr Aktgjykimin Anr.2077/19 përmes të cilit ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, që të shqyrtoje dhe të vendos për ankesën e datës 20.03.2019 të parashtruar nga ankuesja

**Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova:** Plotësimi i ankesës së ankueses i datës 17.05.2021; Aktgjykimi A.nr.2077/2019 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Ankesa e ankueses e datës 20.03.2019 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail i datës 03.05.2019; E-mail i datës 02.05.2019; Diploma e datës 21.02.2014 e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" Fakultetit i Edukimit; Diploma e datës 21.06.2018 e Kolegjit AAB; Ekstrakti nga regjistri qendror i gjendjes civile për Kërkesa për punësim e datës 24.01.2019; Certifikata që nuk je nën hetime; Kopja e letër njoftimit; Referenca e datës 05.08.2016 e lëshuar nga International American of Kosovo; Certifikata ECDL Foundation e datës 18.10.2010; Certifikata e datës 15.10.2010 nga Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkenca dhe Kulturës e Kosovës; Certifikata e datës 27.04.2017; Vërtetimi i përvojës së punës i datës 23.02.2016; Autorizimi i datës 17.01.2019 i lëshuar nga Departamenti i Administrimit të Shërimit Civil/Ministrisë së Administratës Publike; Konkursi i datës 21.01.2019; Zgjatja e afatit të konkursit i datës 06.02.2019; Vendimi i datës 13.02.2019 për formimin e Komisionit Përzgjedhës; Regjistri i Aplikacioneve të Pranuara; E-mail i datës 21.02.2019; Regjistri i kandidatëve të ftuar në testim me shkrim; Ankesa e ankueses e datës 28.02.2019 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Lipjanit; Vendimi i datës



07.03.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Lipjanit si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pasi ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses si dhe të gjitha provat e lëndës një nga një dhe të gjitha së bashku, konstatoj se ankesa e ankueses

*është bazuar, sepse:*

Ankuesja në ankesën e parashtruar pretendon se i ka plotësuar kushtet dhe kriteret e konkursit për pozitën e punës "Zyrtar për Shërbime Sociale 2" me numër 1-111-4492 të datës 22.01.2019 në Komunën e Lipjanit. Me tutje thekson se Komisioni Përzgjedhës nuk ka marrë parasysh përvojën e punës të fituar pas përfundimit të Shkollës së Lartë Pedagogjike, dega Gjuhë dhe Letërsi Shqipe.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, ka shqyrtuar provat e lëndës, dhe si rrjedhojë duke iu referuar konkursit të datës 22.01.2019, ka konstatuar së kritere themelore të konkursit për pozitën e punës "Zyrtar për Shërbime Sociale 2", kanë qenë:

1. *Fakulteti i Sociologjisë, Pedagogjisë dhe Psikologjisë, Shkencat Sociale dhe Jurist i Diplomuar;*
2. *Minimumi 2 vite përvojë pune profesionale.*

Bazuar në shkresat e lëndës, gjegjësisht Diplomën me Nr.940 të datës 20.09.2005 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, është konstatuar se ankuesja me datë 07.07.2005 ka përfunduar Shkollën e Lartë Pedagogjike, dega Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, ndërsa duke u bazuar në Diplomën Nr.215 të datës 17.10.2014, e njëjta me datë 21.02.2014 ka përfunduar studimet në programin Avancimi i Kualifikimit të Mësimdhënësve dhe ka marr titullin Bachlor i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe. Përkitazi me përvojën e punës, Kolegji sipas vërtetimit me numër protokollit 113 të datës 23.02.2016, ka konstatuar se ankuesja ka punuar si mësimdhënëse në SHFMU "Haradin Bajrami" Magure, në periudhën 01.09.2002 - 31.08.2004 dhe 01.09.2005 - 31.08.2015. Andaj, bazuar në këtë konstatim, Kolegji vlerëson se ankuesja ka plotësuar kriterin e përvojës së punës sepse e njëjta me datë 07.07.2005 ka përfunduar Shkollën e Lartë Pedagogjike, dega Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, dhe pas periudhës së diplomimit ka punuar si mësimdhënëse në periudhe prej 10 viteve. Kështu që Kolegji konstaton se Komisioni Përzgjedhës me rastin e mos përfshirjes së ankueses në listën e ngushtë, ka vepruar në kundërshtim me nenin 28 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.2 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: "Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve si në vijim: 1.1 arsinimi dhe kualifikimi profesional, 1.2 përvoja e punës....", dhe nenin 24 paragrafit 1 të njëjtës Rregullore i cili përcakton se: "Përzgjedhja e kandidatëve bëhet përmes shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikacioneve të dorëzuara nga kandidatët e interesuar për pjesëmarrje në procesin e rekrutimit në Shërbimin Civil". E mbi këtë bazë ligjore, Kolegji konstaton se pretendimi ankimor i ankueses në këtë kuptim është i bazuar.

Bazuar në rrethanat e konstatuara si me lartë, Kolegji ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Lipjanit, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me 1-101-68980 të datës 07.03.2019, nuk ka arritur që të vërtetoj drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike lidhur me çështjen kontestuese, duke vepruar kështu në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave.



Andaj, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesës pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, respektivisht bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hynë në fuqi në ditën e anëshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.381/2021

Valentina Kaçandolli BEKTESHI

  
Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI

  
Kryetare e Kolegjit



### Vendimi i dërgohet

- Ankueses,
- Kryetarit të Komunës së Lipjanit;
- Menaxherit të Personelit të Komunës së Lipjanit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

